

## KONTRATË PËR SHITBLERJEN E KUOTAVE

Sot, më datë 28.12.2021, u mblodhën, Shitësi dhe Blerësi, të cilët redaktuan këtë Kontratë Shitblerje, me termat e mëposhtme :

**SHITËSI :** Z. Elvis Himçi, shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike për të vepruar.

**dhe:**

**BLERËSI :** Z. Edvin Kepi, shtetas Shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

### **Baza ligjore**

Kjo kontratë është hartuar bazuar në Legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të veçantë në:

- Kodit Civil, i ndryshuar;
- Ligji për Shoqëritë Tregtare;

Të cilët më hartuan këtë kontrate për shitblerjen e kuotave të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar, si më poshtë vijon:

*DUKE QENË SE EKZISTOJNË KËTO KUSHTE PARAPRAKE:*

Shoqëria, “Albania Human Capital” Sh.p.k e regjistruar ne QKB, datë 30/07/2021, pajisur me NUIS(NIPT) M11930003J , dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e saj të themelimit. Shoqëria ka kapital themeltar të regjistruar prej 100.000 (njëqindmijë) Lekë, të zotëruar nga ortakët:

- Elvis Himçi, zotërues i 50% të kapitalit të shoqërisë;
- Edvin Kepi, zotërues i 50% të kapitalit të shoqërisë.

Me vullnetin e tyre të lirë, kanë vendosur: miratimin e shitjes së 50% të kapitalit të shoqërise që zoterohen nga ortaku, Z. Elvis Himçi, në favor të Z. Edvin Kepi, i cili ka pranuar të blejë kapitalin e ofruara për shitje, duke pranuar të gjitha kushtet, si vijon:

**NENI 1**

## OBJEKTI

Pala Blerëse, blen 50% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 50 lekë, të kapitalit themeltar të shoqërisë tregtare “Albania Human Capital” sh.p.k., në pronësi të Palës Shitëse, duke marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kalimi i pronësisë mbi to.

### NENI 2 KUSHTET

Kuota, objekt i kësaj kontrate, shitet prej Shitësit dhe blihen nga ana e Blerësit, në gjendjen në të cilën rezultojnë aktualisht nga librat e shoqërisë. Pala Blerëse deklaron se është në dijeni të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kalimi i pronësisë së kuotave dhe se i pranon ato ne gjendjen ne të cilën ndodhen, pa patur asnjë pretendim në lidhje me to as sot as në të ardhmen.

### NENI 3 ÇMIMI

Çmimi i ketij operacioni shitblerjeje, përcaktohet, me marrëveshjen e përbashkët të palëve, në shumën 50 Lekë, që korrespondon me vlerën nominale të kuotës.

### NENI 4 MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Pala Shitëse, humbet pronësinë mbi masën prej 50% të kapitalit themeltar të Shoqërisë “Albania Human Capital” sh.p.k., duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi këtë pjesë të kuotave të shoqërisë.

Në të njëjtin moment, Pala Blerëse bëhet pronare e 100% të kapitalit të zotëruara nga Pala Shitëse në kapitalin themeltar të shoqërisë “Albania Human Capital” sh.p.k., Pas realizimit të kësaj kontrate shitblerje, kapiatli i shoqërisë “Albania Human Capital” sh.p.k.. do të zotërohen në këtë mënyrë:

- Z. Edvin Kepi, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë, bëhet zotëruar i një kuote, me vlerë 100 lekë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë.

### NENI 5

### GARANCITË DHE DETYRIMET E PALËS SHITËSE

Pala Shitëse garanton Palën Blerëse:

- a) kjo kontratë lidhet rregullisht nga ana e palës shitëse dhe përcakton lindjen e detyrimeve në ngarkim të saj, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj kontrate.
- b) pala shitëse e deklaron dhe e garanton palën blerëse se ka të gjitha të drejtat dhe kompetencat për të shitur, kaluar, transferuar kuotat në përputhje me kushtet e përmbytura në këtë kontratë.

### NENI 6 TË NDRYSHME

Për aq sa nuk është parashikuar në këtë kontratë do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë që i referohen kontratës së shitblerjes dhe për sa përputhen me objektin e kësaj kontrate.

NENI 7  
DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo kontratë hartohet në katër kopje të njëjta.

Termat e kontratës, pasi u redaktuan në gjuhën Shqipe dhe u nënshkruan nga palët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë.

PALËT

SHITËSI

BLERËSI

Elvis Himçi

Elvis Himçi  


Edvin Kepi

